

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Kreu i Odës Ndërkombëtare të Avokatëve: Aktgjykimi mund të sfidohet si në fakte, ashtu edhe në ligj
ADRESA	https://piranjat.al/kosova/kreu-i-odes-nderkombetare-te-avokateve-aktgjykimi-mund-te-sfi-dohet-si-ne--i104586
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 07:14:39 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 07:07:10 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	8a3e1aa2613bb0b1fea7c05bfa1031ea3ef933e79fc02c2f81bee9b8cdacfea0
TEKSTI	95879aafcb38918fd1caf3af99e1002e34f9736d10ebfc9cce5ce082473a2d31
PAMJA	fad73a0a04299cd6e5d1acf28d7290c03b2624e8dd0909dd9f6005bd0b440527

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	ef0572db699e27a780d8434668fd922846598ba7e7f2e420bc4ccc0a4111c07b
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	81c8c13b2047f7f67d44b50c2b734087e798480a3f28f7a7cb4e41f88dd32922
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/ef0572db699e27a780d8434668fd922846598ba7e7f2e420bc4ccc0a4111c07b>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [EDITORIAL](#)
- [EMISIONE](#)
- [INVESTIGIME](#)
- [AKTUALITET](#)
- [SOCIALE](#)
- [POLITIKË](#)
- [KOSOVA](#)
- [BOTA](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [LIFESTYLE](#)
- [SPORT](#)

[SYRI LIVE](#)



Flash:

sekuestrohen janë
rreth 6 kg arrestuar
konçin tre persona
dhe

denimeve të Bashkuara
Hagës për të
ish- Amerikës

Sarandë, e se
njëri mëkurës
dërrahet në
Sarandë

'Revolucionit kënet
të illogarinë e
Flamingos' saj në
Instagram në

me 12- vjeçare
vjeçaren është
abuzuar
seksualisht

KOSOVA

Kreu i Odës Ndërkombëtare të Avokatëve: Aktgjykimi mund të sfidohet si në fakte, ashtu edhe në ligj

Piranjat Përditësimi i fundit 17 Shtator 2026, 09:07



Aktgjykimi ndaj katër ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës pritet të përballët me një proces të fuqishëm apeli nga të dyja palët, thotë eksperti i së drejtës ndërkombëtare, Mark Ellis.

Në një intervistë për Radion Evropa e Lirë, Ellis, drejtor i Odës Ndërkombëtare të Avokatëve, thotë se mbrojtja pritet të sfidojë konstatimet që lidhin të akuzuarit me ndërmarrjen e përbashkët kriminale, ndërsa Prokuroria mund të kundërshtojë lirin e tyre nga akuzat për krime kundër njerëzimit.

Sipas tij, përtej betejës juridike që vazhdon, aktgjykimi ka rëndësi edhe për viktimat, të cilat tani mund ta shohin dënimin për krime lufte si një formë drejtësie.

Më 16 shtator, Gjykata Speciale në Hagë i shpalli katër ish-krerët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës - Hashim Thaçi, Jakup Krasniqi, Kadri Veseli dhe Rexhep Selimi - fajtorë për katër akuza për krime lufte, ndërsa i liroi nga akuzat për krime kundër njerëzimit.

Thaçi dhe Krasniqi u dënuan me nga 25 vjet burgim, ndërsa Veseli me 18 dhe Selimi me 13.

Aktgjykimi është i shkallës së parë dhe avokatët mbrojtës kanë paralajmëruar se do ta apelojnë atë.

“Aktgjykimi sjell një formë drejtësie për viktimat”

Cili është vlerësimi juaj i parë për aktgjykimin e Dhomave të Specializuara? Çfarë ju bie më shumë në sy?

Mark Ellis: Mendoj se ajo që bie më shumë në sy tani është pyetja që zakonisht shtrohet në situata të tilla: si do të jetë reagimi në nivel lokal dhe cilat do të jenë pasojat për një pranim të mundshëm afatgjatë të vendimit?

Këto procese dhe gjykime janë, siç e dimë, shumë të ndërlikuara, por mund të jenë mjaft pozitive, sepse procesi juridik është shumë rigoroz dhe sfidues.

Shpresa është që pjesë e këtij procesi të jetë një procedurë e fuqishme juridike, e cila në fund prodhon një vendim të arsyetuar mirë, të mbështetur në prova, fakte dhe argumente.

Natyrisht, ky vendim nuk pranohet nga të gjithë.

E dimë saktësisht se çfarë do të ndodhë dhe çfarë po ndodh tani në Kosovë, por kjo nuk është e pazakontë në konflikte të tilla.

Fatkeqësisht, në planin afatshkurtër, vendimi nuk do të shihet pozitivisht nga të gjithë në rajon, por unë do të shikoja drejt një perspektive më afatgjatë.

Historikisht, pas një apo dy brezash, procese të tilla kanë rëndësi.

Mund të kthehemi deri te Nurembergu, te vendimet që u morën atje dhe ndikimi që ato kanë sot. Kështu do ta shihja unë këtë çështje.

Së dyti, ky proces ka qenë gjithmonë i ndërlikuar për shkak të faktit se Dhomat e Specializuara duhej të krijoheshin nga pamundësia për t'i zhvilluar këto procese në Kosovë.

Kur ndodh diçka e tillë, shpesh ka kritika ndaj vetë procesit.

Por, ky ishte i vetmi proces që ishte e mundur të krijohej - në këtë rast, Dhomat e Specializuara të Kosovës - për të mundësuar zhvillimin e një procesi juridik, shqyrtimin e provave për krime të mundshme dhe, më pas, nxjerrjen para përgjegjësisë së atyre që janë përgjegjës për këto krime.

Në fund, e gjithë kjo ka të bëjë me viktimat. Pavarësisht se në cilën anë të një konflikti ndodhet dikush, duhet siguruar zërat e atyre që nuk mund të dëgjohen më.

Për hir të drejtësisë, ky proces është i nevojshëm. Ky proces duhet të ekzistojë.

Të katërtit u liruuan nga akuzat për krime kundër njerëzimit, por u shpallën fajtorë për krime lufte. Cila është rëndësia juridike e këtij dallimi?

Mark Ellis: Nuk kam asnjë dyshim se gjykata i ka kushtuar kohë të konsiderueshme shpjegimit të këtij dallimi. Por, vetë fakti që ata u shpallën fajtorë për krime lufte, është mjaft domethënës.

Nga pikëpamja juridike, natyrisht, gjithmonë më intereson dallimi që bën një gjykatë në vendimin e saj mes gjenocidit, krimeve kundër njerëzimit dhe krimeve të luftës. Por, në fund, kjo do të thotë se kishte prova të mjaftueshme për të dëshmuar se katër individët kryen krime lufte, dhe këto janë krime jashtëzakonisht të rënda.

Kjo do të thotë gjithashtu se viktimat e këtyre krimeve tani mund ta shohin këtë si një formë drejtësie, dhe sigurisht edhe familjarët e tyre dhe të tjerët do të mund ta shohin në këtë mënyrë.

“Konstatimi për ndërmarrjen e përbashkët kriminale është një hap përpara”

Trupi gjykyes e pranoi teorinë kryesore të Prokurorisë të Ekzistencës e një qëllimi të përbashkët kriminal. Çfarë duhej të vërtetonin gjykatësit për të arritur në këtë përfundim?

Mark Ellis: Më duhet ta lexoj më në detaje vendimin, por është një zhvillim i rëndësishëm dhe një hap i rëndësishëm përpara në avancimin e kësaj teorie.

A sjell ky aktgjykim diçka të rëndësishme në jurisprudencën ekzistuese për ndërmarrjen e përbashkët kriminale?

Mark Ellis: Mendoj se vetë fakti, siç e thashë edhe më herët, që ata kanë gjetur prova të mjaftueshme për ta mbështetur këtë qëndrim, është i rëndësishëm. Ky është një hap përpara. Nuk ka asnjë dyshim për këtë. Është një avancim.

Mbrojtja tashmë ka paralajmëruar se do ta apelojë aktgjykimin. Cilat pjesë të aktgjykimit mendoni se mund të kundërshtohen më së shumti në apel?

Mark Ellis: Nuk ka dyshim se do të ketë apel dhe kështu duhet të jetë. Apeli është pjesë e procesit gjyqësor.

Një element i rëndësishëm i aktgjykimit është konstatimi i trupit gjykyes se të katër të akuzuarit ishin pjesë e një ndërmarrjeje të përbashkët kriminale.

Tani do të jetë me rëndësi të shihet se si aktgjykimin e trajton kontributin individual të secilit dhe nëse gjykata ka konstatuar se secili ka kontribuar në mënyrë të konsiderueshme në qëllimin e përbashkët kriminal për shënjestrimin e personave që perceptoheshin si kundërshtarë të synimeve politike dhe ushtarake të UÇK-së.

Duhet pasur parasysh se ende nuk e kam lexuar aktgjykimin në detaje, por gjykatësit duhej të vërtetonin përtej dyshimit të arsyeshëm ekzistencën e këtij qëllimi të përbashkët kriminal.

“Edhe Prokuroria mund ta apelojë aktgjykimin”

Nga përvoja juaj, sa e vështirë është në praktikë që konstatimet eë tilla të rrëzohen në apel?

Mark Ellis: Mendoj se në apel gjithmonë ekziston mundësia të argumentohet se aktgjykimin është i gabuar, qoftë në aspektin faktik, qoftë në atë juridik. Kjo është ajo që do të përpiqet të bëjë mbrojtja.

Por, duhet kujtuar se edhe Prokuroria mund të apelojë.

Sa u përket lirimeve nga akuzat për krime kundër njerëzimit, pres që Prokuroria të argumentojë se trupi gjykyes e ka zbatuar gabimisht kriterin për ekzistencën e një sulmi të gjerë ose sistematik.

Nga ana tjetër, mendoj se mbrojtja do të argumentojë se nuk kishte prova që e lidhnin drejtpërdrejt Thaçin me krime konkrete, apo që dëshmonin se ai kishte kontroll efektiv mbi komandantët. Ky ishte një nga argumentet e mbrojtjes. Pra, ata do të argumentojnë se faktet nuk e mbështesin aktgjykimin.

Mendoj se do të kemi një proces të fuqishëm apeli, nga të dyja palët.

Sa mund të zgjasë procesi i apelit?

Mark Ellis: Është pyetje e mirë. Duke pasur parasysh sa gjatë ka zgjatur gjykimin, edhe apeli mund të marrë kohë. Por, nuk bëhet fjalë për një gjykim të ri - çështja nuk do të rigjykohej nga fillimi.

Në apel do të shqyrtohen çështjet juridike dhe faktet që janë paraqitur gjatë gjykimin. Nuk mund të them saktësisht se sa do të zgjasë procesi, por sigurisht nuk do të zgjasë aq sa gjykimin./REL

Artikuj te sugjeruar

KOSOVA 16 Shtator23:01

[Dënimi i ish-krerëve të UÇK-së/ Zv.kryeministri shqiptar i Malit të Zi: Vendim i padrejtë, procesi nuk ka përfunduar](#)

Zv.kryeministri shqiptar i Malit të Zi, Nik Gjeshaj, ka reaguar pas aktgjykimit të Dhomave të Specializuara të Kosovës në Hagë...

KOSOVA 16 Shtator22:57

[Dënimi i Hashim Thaçit/ Le Monde: Gjykata Speciale kontroverse, përdori edhe prova nga Beogradi](#)

Ish-presidenti i Kosovës Hashim Thaçi, është dënuar me 25 vite burgim nga Dhomat e Specializuara në Hagë për krime luf...

KOSOVA 16 Shtator22:44

[Dënimi i ish-krerëve të UÇK-së, Bardhi ndan foton e të riut: Mos u mërzi, vëllai i vogël! Asnjë vendim nuk e ndryshon historinë e luftës çlirimtare](#)

Kreu i grupit parlamentar të PD-së, Gazment Bardhi, ka reaguar sërish për dënimin e katër ish-krerëve të UÇK-së...

KOSOVA 16 Shtator22:42

[Vuçiç ‘studion’ reagimet e zyrtarëve të lartë të rajonit pas vendimit në Hagë, ndalet te Begaj e Rama, ‘kërcënon’ Malin e Zi](#)

Pas vendimit të dhënë nga Gjykata Speciale e Kosovës në Hagë, ku ish-liderët e UÇK u dënuan me 81 vite burgim p&e...

KOSOVA 16 Shtator22:36

[Vendimi i ish-krerëve të UÇK-së, Bardhi ndan foton e të riut: Mos u mërzi, vëllai i vogël! Asnjë vendim nuk e ndryshon historinë e luftës çlirimtare](#)

[**Vendimi i Hagës, Martens: UÇK-ja nuk mund nga asgjëja, nuk duhet të numërojmë gjykimin historik**](#)

Gazetari i njohur i Frankfurter Allgemeine Zeitung, Michael Martens, ka komentuar vendimin e Gjykatës Speciale në Hagë ndaj ish-drejtesve të...

KOSOVA 16 Shtator22:25

[**“Pse Vuçiç nuk është thirrur në Hagë?” Walker: I mërzitur e zhgënjyer nga BE, vendosi shenjë e barazimit me tmerret serbe**](#)

Një moment të keq për Kosovën, të gjithë Ballkanin dhe Europën e ka konsideruar ish-shefi i misionit të OSBE-së në...

KOSOVA 16 Shtator22:10

[**Djali i Hashim Thaçit reagon pas dënimit të të atit me 25 vjet burg: Kjo betejë nuk ka mbaruar**](#)

Endrit Thaçi, djali i ish-presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, ka reaguar pas vendimit të Dhomave të Specializuara të Ko...

KOSOVA 16 Shtator22:05

[**Si apelohe vendimi i Gjykatës Speciale për krerët e UÇK-së**](#)

Ekipet mbrojtëse të ish-eporëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës kanë paralajmëruar se do të apelojnë...

KOSOVA 16 Shtator21:37

[**“Duke luftuar për Kosovën”, Rita Ora shpërndan të dhënat e viktimave të luftës së Kosovës**](#)

Mes figurave të shumta të njohura për vendimin e aktgjykimit ndaj katër ish-krerëve të UÇK-së, kanë reaguar edhe ...

KOSOVA 16 Shtator21:34

[**Kurbani i fundit për Kosovën**](#)

Nga Lutfi Dervishi: Drejtësia e lypës politike dhe dora e historisë Kur Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi mor...

ME TE VIZITUARAT

AKTUALITET 16 Shtator

[**Sarandë, tre persona plagosen me thikë pranë sh...**](#)

Një ngjarje e rëndë është shënuar mbrëmjen e sotme në Sarandë, ku tre persona kanë mbetur të plagosur me ...

BOTA 16 Shtator

[**VIDEO- Dy aksidente me pesë viktimë/ Prezantues...**](#)

Pesë persona kanë humbur jetën në një aksident të dyfishtë tragjik në Los Anxhelos, ndërsa një gazetare televi...

KOSOVA 16 Shtator

[**Kush është Charles Smith, gjyqtari që dënoi me...**](#)


Charles L. Smith III është gjyqtari amerikan që kryesoi trupin gjyqës në çështjen ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, R...

INVESTIGIME 31 Maj14:01

[**Gratteri për Piranjat: Kam 38 vite që më duan të vdekur ndaj nuk dal kurrë në publik**](#)

Për më shumë se tre dekada, jeta e kryeprokurorit italian të antimafias, Nicola Gratteri, ka qenë nën hijen e kërcënimev...

video





E premte | ? 20:45 | Syri TV



E premte | ? 20:45 | Syri TV



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.